HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

TRANSPARENCA FINANCIARE E UNIVERSITETEVE PUBLIKE *2023*



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Autor:
Gramos Buçinca

Hulumtues:
Olisa Çekaj, Skord Retkoceri, Dibran Hoxha

Prishtinë, nëntor 2024

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

05 Hyrje

08 Gjetjet e përgjithshme
10 Buxheti për universitete publike 2023
12 Relacioni i buxhetit me student/staf/programe
15 Gjetjet e grumbulluara për pagat e stafit akademik menaxherial

19 Gjetjet për secilin universitet
19 Universiteti i Pejës
31 Universiteti i Prizrenit
43 Universiteti i Mitrovicës
55 Universiteti i Gjilanit
67 Universiteti i Gjakovës
79 Universiteti i Ferizajt
91 Universiteti i Prishtinës

104 Metodologjia

112 Bibliografia

Hyrja

Universitetet publike në Kosovë janë falas për studentë të të gjitha niveleve me përjashtim të doktoratës. Për këto universitete, Qeveria e Kosovës ndanë mbi 50 milion Euro në vit nga paraja publike e mbledhur nga taksapaguesit. Si të tillë, universitetet publike janë nën llupën shtetërore dhe të shoqërisë civile për të parë se si shpenzohen paratë publike që janë ndarë për ta. Për më tepër, është e rëndësishme të kuptohet se si disa universitete marrin më pak ose më shumë grante qeveritare nga të tjerët.

Stafi akademik i universiteteve publike i ka rrogat më të larta në sektorin publik, me përjashtim të disa pozitave në nivele të larta në Qeveri, të cilat mbajnë përgjegjësi për qindra miliona Euro, e për qindra mijëra qytetarë. Në të kaluarën, anëtarët e stafit akademik kanë bllokuar hapjen e pozitave për staf të ri duke i caktuar vetvetes punë shtesë për të cilën janë kompensuar në shuma të larta.

Për të kuptuar se si është ndarja mes pagës bazë së stafit akademik dhe shtesave që ata i marrin si punë shtesë në ligjërata dhe ushtrime, Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim në 2019 pati publikuar raportin e parë për transparencën dhe llogaridhënien në universitetet publike në Kosovë 'Borgjezia e Akademisë', ku ishin hulumtuar deklarimet e pasurive të të gjithë anëtarëve të stafit akademik menaxherial të universiteteve publike si rektorët, prorektorët, dekanët, prodekanët dhe anëtarët akademik të këshillave drejtuese. Gjetja kryesore ishte se shtesat – pagesat për mbinorma – përbënin mesatarisht 42% të pagave të tyre mujore për ligjërata dhe ushtrime. Disa prej tyre madje merrnin më shumë para nga shtesat sesa paga bazë!

Pas vitit 2019 shihet një rënie e pagave, shtesave dhe më e rëndësishmja vërehet rënie e hises së shtesave në pagat e stafit akademik menaxherial, nga 42% në 31% të pagës.

Monitorimi i pagave të stafit akademik përmes deklarimit të pasurive që ata i bëjnë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit e rritë transparencën dhe arrin rezultat konkret në hapjen e universiteteve publike për mësimdhënës të rinj cilësor.

Në këtë raport janë paraqitur ndarjet buxhetore për universitete publike, raporti i buxheteve për kokë studenti dhe program të studimit, të ardhurat e stafit akademik dhe shtesat që ata i marrin mbi pagën bazë – si të dhëna të grumbulluara dhe për secilin nga shtatë universitetet veçmas.

Gjetjet e përgjithshme

Gjetjet kryesore

- Pagat e stafit akademik menaxherial dhe shtesat që ata i marrin mbi pagën bazë kanë pësuar rënie të vazhdueshme ndër vite. Në vitin 2019 pagat për këtë kategori ishin mesatarisht 2013 Euro në muaj, prej të cilave shtesa ishin mesatarisht 836 Euro. Në vitin 2023 këto paga dhe shtesat mesatare mujore kanë rënë në 1834 Euro dhe 566 Euro respektivisht.

- Në vitin 2023, për herë të parë që nga viti 2019 kur është bërë matja e parë nga ORCA, kategoria më e paguar nga stafi akademik menaxherial janë dekanët me mesatarisht 1906 Euro në muaj. Në vendin e dytë janë anëtarët e rektoratit si rektori dhe prorektorët me mesatarisht 1895 Euro në muaj.

- Në vitin 2019 shtesat e përbënin 42% të pagës mesatare të stafit menaxherial akademik në universitete publike. Në vitin 2023 kjo ka rënë në 31%.

- Dallimi në paga mes stafit menaxherial është zvogëluar dukshëm në vitin 2023. Nëse në vitin 2020 dallimi mes kategorisë më të paguar dhe asaj më pak të paguar ishte 924 Euro, në vitin 2023 ky dallim ishte 169. Gjë që tregon për një shpërndarje më horizontale të pagesave të stafit menaxherial akademik nëpër universitete publike.

- Universiteti i Gjakovës ka marrë disproporcionalisht më shumë grante qeveritare sesa universitetet e tjera publike, nëse e matim në raport me numrin e studentëve dhe të programeve studimore që i kanë. Ndërkaq, Universitet i Prizrenit ka marrë më së paku grante qeveritare në raport me numrin e studentëve dhe të programeve studimore që i ka.

- Universiteti i Ferizajit nuk ka paraqitur shpenzime për bursa, shkencë dhe detaje të shpenzimeve kapitale në raportin e tyre financiar.

Buxheti për universitete publike 2023

Buxheti total i universiteteve publike në Kosovë në vitin 2023 ishte 52,324,266.00 Euro. 97%, ose saktësisht 50,839,800.00 Euro janë ndarë nga buxheti i Kosovës, që do të thotë taksapaguesi i cili nuk është i regjistruar si student, paguan pothuajse tërë faturën e arsimit të lartë publik në Kosovë.

62% e buxhetit të universiteteve publike ka shkuar në paga dhe mëditje, 12% në mallra dhe shërbime, 4% në shpenzime komunale, 4% në subvencione dhe transfere, dhe 18% në shpenzime kapitale.

Linja buxhetore	Buxheti 2023
Paga dhe mëditje	32,530,658 €
Mallra dhe Shërbime	6,250,000 €
Shpenzime komunale	1,829,608 €
Subvencione dhe Transfere	2,044,000 €
Shpenzime Kapitale	9,670,000 €
Totali	**52,324,266 €**

Universiteti i Prishtinës edhe në 2023 e pati buxhetin më të madh me rreth 62% të totalit të buxhetit për arsim të lartë publik. Universiteti i Pejës pasoi i dyti me 9%, i Mitrovicës me 7%. Vazhduan me 6% universitetet e Gjakovës dhe të Prizrenit, dhe me nga 5% të totalit ishin universiteti i Ferizajt dhe i Gjilanit.

Universiteti	Buxheti 2023	Përqindja nga totali
Universiteti i Prishtinës	32,666,582 €	62%
Universiteti i Pejës	4,358,739 €	9%
Universiteti i Mitrovicës	3,852,459 €	7%
Universiteti i Gjakovës	3,226,849 €	6%
Universiteti i Prizrenit	3,204,082 €	6%
Universiteti i Ferizajt	2,703,351 €	5%
Universiteti i Gjilanit	2,312,204 €	5%
Totali	**52,324,266 €**	**100%**

Relacioni i buxhetit me student/staf/programe

Në universitete publike në vitin 2023 u regjistruan 40,652 studentë. Këto universitete shpenzuan mesatarisht 1287 Euro për student. Universiteti i cili e kishte raportin buxhet për kokë studenti dukshëm më të lartë ishte ai i Gjakovës me 6519 Euro për studentë. Ndërkaq raportin më të ulët e kishte ai i Prizrenit me 965 Euro.

Universiteti	Nr. i studentëve	Buxheti	Buxheti për kokë studenti
Gjakovë	495	3,226,849 €	6,519 €
Mitrovicë	1,807	3,852,459 €	2,132 €
Ferizaj	1,523	2,703,351 €	1,775 €
Gjilan	1,741	2,312,204 €	1,328 €
Prishtinë	27,969	32,666,582 €	1,168 €
Pejë	3,795	4,358,739 €	1,149 €
Prizren	3,322	3,204,082 €	965 €

Mesatarja e buxhetit për kokë studenti: **1,287 €**

Për të analizuar tutje shpërndarjen buxhetore të universiteteve, e kemi analizuar edhe raportin e buxhetit me program të studimit të akreditуar. Në 2023, 243 mijë e 369 Euro mesatarisht janë ndarë për çdo program të studimit me akreditim në universitete publike. Shihet që Universiteti i Gjakovës në 2023 ka marrë më shumë fonde për program studimi me akreditim. Ndërkaq Universitet i Prizrenit ka marrë më së paku.

Universiteti	Nr. i programeve	Buxheti	Raporti buxhet/program
Gjakovë	9	3,226,849 €	358,539 €
Mitrovicë	16	3,852,459 €	272,421 €
Ferizaj	10	2,703,351 €	270,335 €
Gjilan	16	2,312,204 €	240,779 €
Prishtinë	140	32,666,582 €	233,333 €
Pejë	10	4,358,739 €	231,220 €
Prizren	14	3,204,082 €	228,863 €

Mesatarja e buxhetit për program: **243,369 €**

Për të analizuar tutje shpërndarjen buxhetore të universiteteve, e kemi analizuar edhe raportin e buxhetit me program të studimit të akredituar. Në 2023, 243 mijë e 369 Euro mesatarisht janë ndarë për çdo program të studimit me akreditim në universitete publike. Shihet që Universiteti i Gjakovës në 2023 ka marrë më shumë fonde për program studimi me akreditim. Ndërkaq Universitet i Prizrenit ka marrë më së paku.


Gjetjet e grumbulluara për pagat e stafit akademik menaxherial

Në vitin 2023 të ardhurat e stafit akademik menaxherial që përbëjnë rektoratet dhe dekanatet e universiteteve publike ishin mesatarisht 1,834 Euro në muaj, që paraqet një rënie prej 40 Euro, apo rreth 2% më pak se në vitin 2022. Po ashtu, shtesat mesatare që ata i kanë marrë mbi pagën bazë pa llogaritur angazhimet jashtë ligjëratave apo ushtrimeve ishin 566 Euro, ose rreth 7% më pak se në vitin 2022.

Viti	Paga mesatare mujore	Shtesat mesatare mujore	Përqindja e shtesave në paga
2019	2,013 €	836 €	42%
2020	1,916 €	696 €	36%
2021	1,804 €	574 €	32%
2022	1,874 €	606 €	32%
2023	1,834 €	566 €	31%


Bazuar në deklarimet e pasurisë të vitit 2023 të stafit akademik menaxherial, të hyrat mesatare më të larta i kishte Universiteti i Prishtinës me 2,026 Euro në muaj. Ndërkaq shtesat mesatare më të larta i pati stafi akademik menaxherial i Universitetit të Pejës me 750 Euro në muaj. Në grafikun e mëposhtëm mund të i shihni se si shpërndahen të hyrat dhe shtesat ndër universitete.

Të hyrat dhe shtesat mesatare të stafit akademik menaxherial në universitete publike



Nëse e shohim që nga matja e parë e ORCA-së në vitin 2019, pagat mujore dhe shtesat e stafit akademik menaxherial kanë pësuar një rënie graduale. Shtesat mbi pagën bazë që përfshijnë vetëm angazhimet në mbinorma kanë rënë në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2019 kur ishin mesatarisht 836 Euro, në 566 në vitin 2023. Përkthyer në përqindje, i bie që shtesat në vitin 2019 përbënin 42% të të ardhurave të stafit akademik menaxherial ndërkaq në vitin 2023 ato kanë rënë në 31%.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në universitete publike



Ndërkaq sa i përket pozitave të rektorëve, prorektorëve, dekanëve, prodekanëve dhe anëtarëve akademik të këshillave drejtues, mund të vërehet se në vitin 2023 kanë një shtrirje të barabartë ku paga mesatare mujore e atyre që janë paguar më së shumti ka dallim për vetëm 169 Euro. Në vitin 2020 ky hendek ishte 924 Euro.

Situata është e ngjashme edhe për shtesat mbi pagën bazë. Nëse në vitin 2019 dallimi mes shtesave mesatare më të larta dhe atyre më të ulëta ishte 668 Euro, në vitin 2023 ky dallim është zvogëluar në vetëm 65 Euro. Në vitin 2022 nuk është bërë matja për anëtarët e këshillit drejtues që vijnë nga ana e profesoriatit.

Gjetjet për secilin universitet

Universiteti i Pejës

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Pejës ka 82 anëtarë të stafit akademik të rregullt, prej tyre 36 gra dhe 36 burra, si dhe 73 të angazhuar, prej tyre 26 gra dhe 46 burra. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: 82 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 36 gra, 36 burra. 73 të angazhuar, 26 gra, 46 burra.
- 2021/2022: 83 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 35 gra, 48 burra. 59 të angazhuar, 13 gra, 46 burra.
- 2020/2021: 76 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 32 gra, 44 burra. 75 të angazhuar, 12 gra, 63 burra.
- 2019/2020: 70 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 30 gra, 53 burra. 40 të angazhuar, 9 gra, 55 burra.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në Universitetin e Pejës në vitin 2022/2023 ishin 3,795 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 432 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Pejës		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	1,418	2,582	2,867	3,916
	Djem	1,543	4,243	4,905	5,697
	Gjithsej	2,961	6,825	7,772	9,613
Master	Vajza	473	794	635	840
	Djem	361	750	558	630
	Gjithsej	834	1,544	1,193	1,470
Total		**3,795**	**8,369**	**8,965**	**11,083**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Pejës		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	241	191	191	276
	Djem	67	119	120	143
	Gjithsej	308	310	311	419
Master	Vajza	84	127	134	128
	Djem	40	75	69	73
	Gjithsej	124	202	203	201
Total		**432**	**512**	**514**	**620**

Vërehet një rënie e dukshme e numrit të studentëve. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020 në Universitetin e Pejës në 2022/2023 kemi 66% më pak studentë. Po ashtu vërehet një rënie e lehtë e të diplomuarve me 21% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Pejës në vitin 2023 ishte 4,358,739 Euro, i ndarë 58% në paga dhe mëditje, 14% në mallra dhe shërbime, 1% në shpenzime komunale, 2% në subvencione dhe grante dhe 25% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Pejës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Të gjitha mjetet që i gjeneron vet, Universiteti i Pejës i shpenzon në paga dhe mëditje. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet të financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Pejës në vitin 2023 ka pasur ngritje të buxhetit prej 837 mijë e 77 Euro në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Pejës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€1,848,129	55%
	2020	€1,727,717	46%
	2021	€1,656,746	62%
	2022	€2,272,717	65%
	2023	**€2,509,794**	**58%**
Mallra dhe shërbime	2019	€412,007	12%
	2020	€412,007	11%
	2021	€500,000	19%
	2022	€603,000	17%
	2023	**€603,000**	**14%**
Shpenzime komunale	2019	€50,408	1%
	2020	€50,408	1%
	2021	€50,408	2%
	2022	€50,408	1%
	2023	**€50,408**	**1%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Pejës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€100,000	3%
	2020	€100,000	3%
	2021	€100,000	4%
	2022	€100,000	3%
	2023	**€100,000**	**2%**
Shpenzime kapitale	2019	€970,000	29%
	2020	€1,470,000	39%
	2021	€350,000	13%
	2022	€470,000	13%
	2023	**€1,070,000**	**25%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€3,380,544	**100%**
	2020	€3,760,132	
	2021	€2,657,154	
	2022	€3,496,125	
	2023	**€4,333,202**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Pejës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Pejës kanë pasur ngritje të lehtë prej 19 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon rritje për afro 1% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 750 Euro në muaj njësoj siç kishin qenë edhe në 2022.

Në vitin 2023, shtesat përbënin 37 % të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Pejës.


Në Universitetin e Pejës ngritjen më të madhe mesatare të të hyrave mujore e kanë pasur Prodekanët, nga 1735 Euro në vitin 2021, në 2209 Euro në 2023. Ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur Prodekanët, nga 588 Euro në vitin 2021, në 872 Euro në 2023.

Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Pejës



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Pejës



Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Pejës

Duke u bazuar në raportin vjetor financiar për vitin 2023 të Universitetit të Pejës, ky universitet ka shpenzuar 68,400 Euro për bursa të studentëve. Në vitin 2020 Universiteti i Pejës kishte shpenzuar 40,850 Euro për bursa për studentë, ndërkaq për vitin 2019 kishte shpenzuar 64,800 Euro.

Për shkencë, që përfshinë mbështetjen e stafit akademik për publikime në revista shkencore, hulumtime dhe projekte, Universiteti i Pejës ka shpenzuar 29,700 Euro. Në vitin 2020 ky universitet kishte shpenzuar 5,339 Euro për shkencë, ndërkaq në 2019 kishte shpenzuar 17,473 Euro.

Për shpenzime kapitale, Universiteti i Pejës ka shpenzuar 1,889,630 Euro. Këtu përfshihen objekte arsimore 1,860,540 Euro, pajisje të tjera 27,220 Euro dhe blerja e pajisjeve laboratorike dhe të IT-së për universitetin 1,890 Euro. Shpenzimet kapitale në vitin 2020 ishin 542,893 Euro, ndërkaq për vitin 2019 ato ishin 662,347 Euro.

Raporti i auditorit për Universitetin e Pejës

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 kishte gjetur se në Planifikimin Financiar Vjetor të vitit 2023, detyrimet kontigjente të Universitetit të Pejës nuk ishin prezantuar.

Universiteti i Prizrenit

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Prizrenit ka 87 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 26 gra dhe 61 burra, si dhe 115 të angazhuar, prej tyre 55 gra dhe 60 burra. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: 87 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 26 gra, 61 burra. 115 të angazhuar, 55 gra, 60 burra.
- 2021/2022: 84 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 26 gra, 58 burra. 131 të angazhuar, 52 gra, 79 burra.
- 2020/2021: 80 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 25 gra, 55 burra. 114 të angazhuar, 39 gra, 75 burra.
- 2019/2020: 77 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 24 gra, 53 burra. 87 të angazhuar, 32 gra, 55 burra.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Universitetin e Prizrenit në vitin 2022/2023 ishin 3322 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 808 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Prizrenit		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	2081	2299	2,750	2,776
	Djem	975	1055	1232	1,000
	Gjithsej	3056	3354	3982	3776
Master	Vajza	143	157	172	144
	Djem	123	146	176	115
	Gjithsej	266	303	348	259
Total		**3322**	**3657**	**4330**	**4035**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Prizrenit		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	596	640	691	620
	Djem	128	210	209	237
	Gjithsej	724	850	900	857
Master	Vajza	53	74		
	Djem	31	39		
	Gjithsej	84	113		
Total		**808**	**963**	**900**	**857**

Vërehet një rënie e ndjeshme e numrit të studentëve. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020 në Universitetin e Prizrenit në 2022/2023 kemi 24% më pak studentë. Po ashtu vërehet një rënie e lehtë e të diplomuarve me 6% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Prizrenit në vitin 2023 ishte 3,136,082 Euro, i ndarë 65% në paga dhe mëditje, 19% në mallra dhe shërbime, 2% në shpenzime komunale, 3% në subvencione dhe grante dhe 11% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Prizrenit financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Të gjitha mjetet që i gjeneron vet, Universiteti i Prizrenit i shpenzon në paga dhe mëditje. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Prizrenit në vitin 2023 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 7 mijë e 646 Euro më pak në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Prizrenit

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€1,597,944	63%
	2020	€1,545,728	62%
	2021	€1,347,540	59%
	2022	€2,070,728	66%
	2023	**€2,013,082**	**65%**
Mallra dhe shërbime	2019	€600,000	23%
	2020	€600,000	24%
	2021	€600,000	26%
	2022	€700,000	22%
	2023	**€600,000**	**19%**
Shpenzime komunale	2019	€73,000	3%
	2020	€73,000	3%
	2021	€73,000	3%
	2022	€73,000	2%
	2023	**€73,000**	**2%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Prizrenit

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€100,000	3%
	2020	€100,000	3%
	2021	€100,000	4%
	2022	€100,000	3%
	2023	**€100,000**	**3%**
Shpenzime kapitale	2019	€200,000	8%
	2020	€200,000	8%
	2021	€180,000	8%
	2022	€200,000	6%
	2023	**€350,000**	**11%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€2,570,944	**100%**
	2020	€2,518,728	
	2021	€2,300,540	
	2022	€3,143,728	
	2023	**€3,136,082**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Prizrenit janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Prizrenit kanë pasur ngritje të lehtë nga 41 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon rritje për afro 3% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 484 Euro në muaj, një ngritje prej 5% krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2023, shtesat përbënin 27 % të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Prizrenit.


Në Universitetin e Prizrenit ngritjen më të madhe mesatare të të hyrave mujore e kanë pasur Prodekanët, nga 1828 Euro në vitin 2021, në 1920 Euro në 2023. Ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e profesoriatit, nga 504 Euro në vitin 2021, në 585 Euro në 2023.

Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prizrenit



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prizrenit



Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Prizrenit

Duke u bazuar në raportin vjetor financiar për vitin 2023 të Universitetit të Prizrenit, ky universitet ka shpenzuar 100,000 Euro për bursa të studentëve. Në vitin 2020 Universiteti i Prizrenit kishte shpenzuar 99,985 Euro për bursa për studentë, ndërkaq për vitin 2019 kishte shpenzuar 68,805 Euro.

Në raportin e tij financiar, Universiteti i Prizrenit nuk ka paraqitur shpenzime të kryera për shkencë.

Për shpenzime kapitale, Universiteti i Prizrenit ka shpenzuar 311,439 Euro. Këtu përfshihen renovimi i objekteve ekzistuese të Fakultetit Juridik 14,499 Euro, renovimi i objekteve ekzistuese të Fakultetit Filologjik 265,145 Euro, si dhe blerja e një veture në vlerë prej 31,795 Euro.

Raporti i auditorit për Universitetin e Prizrenit

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 kishte gjetur se në Planifikimin Financiar Vjetor të vitit 2023, detyrimet kontigjente të Universitetit të Prizrenit nuk ishin prezantuar.

Universiteti i Mitrovicës

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Mitrovicës ka 108 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 38 gra dhe 70 burra, si dhe 26 të angazhuar, prej tyre 9 gra dhe 17 burra. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: 108 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 38 gra, 70 burra. 26 të angazhuar, 9 gra, 17 burra.
- 2021/2022: 103 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 31 gra, 72 burra. 35 të angazhuar, 13 gra, 22 burra.
- 2020/2021: 103 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 30 gra, 73 burra. 32 të angazhuar, 11 gra, 21 burra.
- 2019/2020: 95 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 29 gra, 66 burra. 19 të angazhuar, 2 gra, 17 burra.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Universitetin e Mitrovicës në vitin 2022/2023 ishin 1807 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 393 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Mitrovicës		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	1073	1105	1316	1126
	Djem	586	609	717	534
	Gjithsej	1659	1714	2033	1660
Master	Vajza	83	111	73	72
	Djem	65	81	83	80
	Gjithsej	148	192	156	152
Total		**1807**	**1906**	**2189**	**1812**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Mitrovicës		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	247	284	173	140
	Djem	89	222	83	96
	Gjithsej	336	506	256	236
Master	Vajza	40	28	19	18
	Djem	17	26	13	28
	Gjithsej	57	54	32	46
Total		**393**	**560**	**288**	**282**

Vërehet një rënie e ndjeshme e numrit të studentëve. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020, në Universitetin e Mitrovicës në 2022/2023 nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar. Ndërkaq, vërehet një ngritje e dukshme e të diplomuarve për 40% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Mitrovicës në vitin 2023 ishte 3,852,459 Euro, i ndarë 74% në paga dhe mëditje, 14% në mallra dhe shërbime, 6% në shpenzime komunale, 3% në subvencione dhe grante dhe 3% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Mitrovicës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Të gjitha mjetet që i gjeneron vet, Universiteti i Mitrovicës i shpenzon në paga dhe mëditje. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Mitrovicës në vitin 2023 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 266 mijë e 74 Euro më pak në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Mitrovicës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€2,642,769	57%
	2020	€2,765,045	68%
	2021	€2,765,045	73%
	2022	€2,879,706	70%
	2023	**€2,863,632**	**75%**
Mallra dhe shërbime	2019	€866,339	19%
	2020	€366,339	9%
	2021	€450,000	12%
	2022	€543,154	13%
	2023	**€543,154**	**14%**
Shpenzime komunale	2019	€215,000	5%
	2020	€215,200	5%
	2021	€215,200	6%
	2022	€215,200	5%
	2023	**€215,200**	**6%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Prizrenit

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€100,000	2%
	2020	€100,000	2%
	2021	€100,000	3%
	2022	€100,000	2%
	2023	**€100,000**	**3%**
Shpenzime kapitale	2019	€850,000	17%
	2020	€650,000	16%
	2021	€240,000	6%
	2022	€350,000	9%
	2023	**€100,000**	**3%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€4,674,308	**100%**
	2020	€4,096,584	
	2021	€3,770,245	
	2022	€4,088,060	
	2023	**€3,821,986**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Mitrovicës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Mitrovicës kanë pasur rënie të ndjeshme prej 125 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon zbritje për afro 6% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 491 Euro në muaj, një zbritje prej 26% krahasuar me vitin 2022. Në vitin 2023, shtesat përbënin 27% të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Mitrovicës.

Në Universitetin e Mitrovicës ngritjen më të madhe mesatare të të hyrave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 1746 Euro në vitin 2021, në 2019 Euro në vitin 2023.


Ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 620 Euro në vitin 2021, në 787 Euro në 2023.

Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës



Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Mitrovicës

Duke u bazuar në raportin vjetor financiar për vitin 2023 të Universitetit të Mitrovicës, ky universitet ka shpenzuar 95,152.16 Euro për bursa të studentëve, stimulimin e autorëve për libra si dhe stimulimin e personelit akademik për botimin e punimeve shkencore në revista prestigjioze. Në vitin 2021 Universiteti i Mitrovicës kishte shpenzuar 45,820 Euro për bursa për studentë, ndërkaq për vitin 2020 kishte planifikuar 100,000 Euro.

Në raportin e tij financiar Universiteti i Mitrovicës nuk ka paraqitur shpenzime të ndara për shkencë, por vetëm si të grumbulluara të paraqitura në paragrafin më sipër. Në vitin 2021 Universiteti i Mitrovicës nuk kishte paraqitur të dhëna konkrete për shpenzime në shkencë, ndërkaq në vitin 2020 ai kishte shpenzuar 552 Euro.

Për shpenzime kapitale Universiteti i Mitrovicës në vitin 2023 ka shpenzuar 105,355 Euro. Këtu përfshihen furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike 20,000 Euro, furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave 35,267 Euro, furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore 20,000 Euro, furnizim me pajisje për teknologji informative 20,000 dhe ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/kampusi 10,088 Euro.

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 nuk ka paraqitur asnjë gjetje për Universitetin e Mitrovicës.

Universiteti i Gjilanit

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Gjilanit ka 59 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 18 gra dhe 41 burra, si dhe 74 të angazhuar, prej tyre 32 gra dhe 42 burra. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: 59 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 18 gra, 41 burra. 74 të angazhuar, 32 gra, 42 burra.
- 2021/2022: 47 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 14 gra, 33 burra. 46 të angazhuar, 20 gra, 26 burra.
- 2020/2021: 78 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 30 gra, 48 burra. 50 të angazhuar, 17 gra, 33 burra.
- 2019/2020: 47 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 12 gra, 35 burra. 24 të angazhuar, 25 gra, 49 burra.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Universitetin e Gjilanit në vitin 2022/2023 ishin 3141 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 346 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Gjilanit		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	1418	1320	1603	1694
	Djem	1543	207	747	828
	Gjithsej	2961	1527	2350	2522
Master	Vajza	132	142	97	65
	Djem	48	67	94	72
	Gjithsej	180	209	191	137
Total		**3141**	**1736**	**2541**	**2659**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Gjilanit		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	241	99	248	334
	Djem	67	30	88	103
	Gjithsej	308	129	336	437
Master	Vajza	17	3		
	Djem	21	2	1	
	Gjithsej	38	5	1	0
Total		**346**	**134**	**337**	**437**

Vërehet një ngritje e dukshme e numrit të studentëve. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020 në Universitetin e Gjilanit në 2022/2023 ka 18% më shumë studentë. Ndërkaq, vërehet një zbritje e dukshme e të diplomuarve për 21% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Gjilanit në vitin 2023 ishte 2,312,204 Euro, i ndarë 64% në paga dhe mëditje, 22% në mallra dhe shërbime, 2% në shpenzime komunale, 5% në subvencione dhe grante dhe 7% në shpenzime kapitale.

95% i buxhetit të Universitetit të Gjilanit financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 5% e gjeneron vet. Të gjitha mjetet që i gjeneron vet, Universiteti i Gjilanit i shpenzon në paga dhe mëditje. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Gjilanit në vitin 2023 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 207 mijë e 362 Euro më pak në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Gjilanit

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€1,183,783	53%
	2020	€1,183,783	52%
	2021	€1,173,456	60%
	2022	€1,527,643	64%
	2023	**€1,420,281**	**64%**
Mallra dhe shërbime	2019	€316,339	14%
	2020	€316,339	14%
	2021	€400,000	20%
	2022	€476,923	20%
	2023	**€476,923**	**22%**
Shpenzime komunale	2019	€50,000	2%
	2020	€50,000	2%
	2021	€50,000	3%
	2022	€50,000	2%
	2023	**€50,000**	**2%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Gjilanit

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€100,000	4%
	2020	€100,000	4%
	2021	€100,000	5%
	2022	€100,000	4%
	2023	**€100,000**	**5%**
Shpenzime kapitale	2019	€600,000	27%
	2020	€650,000	28%
	2021	€240,000	12%
	2022	€300,000	12%
	2023	**€150,000**	**7%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€2,250,122	**100%**
	2020	€2,300,122	
	2021	€1,963,456	
	2022	€2,404,566	
	2023	**€2,197,204**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Gjilanit janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Gjilanit kanë pasur rënie të dukshme prej 327 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon zbritje për afër 16% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 546 Euro në muaj, një zbritje prej 27% krahasuar me vitin 2022.


Në vitin 2023, shtesat përbënin 32% të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Gjilanit.

Në Universitetin e Gjilanit nuk ka pasur ngritje të të ardhurave mujore të stafit menaxherial, përkundrazi të gjitha nivelet e menaxhmentit kanë pasur reduktim të tyre. Nuk ka pasur as ngritje të shtesave mujore të stafit menaxherial, përkundrazi të gjitha nivelet e menaxhmentit kanë pasur reduktim të tyre. Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjilanit



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjilanit



Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Gjilanit

Duke u bazuar në raportin vjetor financiar për vitin 2023 të Universitetit të Gjilanit, ky universitet ka shpenzuar 58,400 Euro për bursa të studentëve, 220 Euro për gara të studentëve, 250 Euro për përfaqësimin e studentëve në gara në Shqipëri, dhe 4,900 Euro për përfaqësimin e studentëve në Universitetin Ph Zug. Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për bursa për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuara nga UKZ, thuhet se shuma totale e shpenzuar për bursa gjatë vitit akademik 2020/2021 është 84 mijë e 750 Euro të ndara për 113 studentë në shumën prej 750.

Në raportin e tij financiar Universiteti i Gjilanit ka paraqitur shpenzime të ndara për kompensim për punime shkencore, hulumtuesi i vitit 2022, pagesën e konferencave për stafin akademik në vlerë prej 9,541 Euro. Nuk ka informata publike për shpenzimet për shkencë për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuara nga UKZ,

thuhet se shuma totale e shpenzuar për fondin për shkencë gjatë vitit 2020 është 1 mijë e 109 Euro, ndërsa për vitin 2021 ishte planifikuar shuma prej 10 mijë Euro.

Për shpenzime kapitale Universiteti i Gjilanit në vitin 2023 ka shpenzuar 113,957 Euro. Këtu përfshihen ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës në UKZ në vlerë prej 92,757 Euro, blerja e mobilieve në vlerë prej 4,250 Euro, pajisje të IT-së në vlerë prej 16,950 Euro.

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 nuk ka paraqitur asnjë gjetje për Universitetin e Gjilanit.

Universiteti i Gjakovës

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Gjakovës ka 4 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 1 grua dhe 3 burra, si dhe 9 të angazhuar, prej tyre 4 gra dhe 5 burra. Kjo statistikë duket që nuk qëndron sepse ka dallim të madh me numrin e stafit i cili është i paraqitur në faqen zyrtare të universitetit, andaj në këtë rast janë shfrytëzuar të dhënat nga faqja, që tregojnë se në Universitetin e Gjakovës në 2022/2023 kishte 69 staf akademik të rregullt, prej tyre 45 profesorë. Nga profesorët 12 janë gra dhe 32 janë burra. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: nuk ka të dhëna të sakta nga Statistikat e Arsimit 2022/2023.
- 2021/2022: 63 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 30 gra, 33 burra. 46 të angazhuar, 20 gra, 26 burra.
- 2020/2021: 56 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 26 gra, 30 burra. 52 të angazhuar, 23 gra, 29 burra.
- 2019/2020: 50 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 22 gra, 28 burra. 32 të angazhuar, 14 gra, 18 burra.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Universitetin e Gjakovës në vitin 2022/2023 ishin 495 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 66 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Gjakovës		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	327	1240	1,303	1,399
	Djem	111	207	214	254
	Gjithsej	438	1447	1517	1653
Master	Vajza	41	22		
	Djem	16	8		
	Gjithsej	57	30	0	0
Total		**495**	**1477**	**1517**	**1653**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Gjakovës		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	50	324	128	318
	Djem	16	56	18	63
	Gjithsej	66	380	146	381
Master	Vajza	0	0	0	0
	Djem	0	0	0	0
	Gjithsej	0	0	0	0
Total		**66**	**380**	**146**	**381**

Vërehet një rënie e dukshme e numrit të studentëve. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020 në Universitetin e Gjakovës në 2022/2023 ka 70% më pak studentë. Vërehet po ashtu një rënie e jashtëzakonshme e të diplomuarve për 83% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Gjakovës në vitin 2023 ishte 3,226,849 Euro, i ndarë 38% në paga dhe mëditje, 15% në mallra dhe shërbime, 2% në shpenzime komunale, 3% në subvencione dhe grante dhe 42% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Gjakovës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Të gjitha mjetet që i gjeneron vet, Universiteti i Gjakovës i shpenzon në paga dhe mëditje. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Gjakovës në vitin 2023 ka pasur një ngritje të dukshme të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 429 mijë e 419 Euro më shumë në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Gjakovës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€1,184,828	50%
	2020	€1,184,828	52%
	2021	€1,181,477	55%
	2022	€1,243,707	45%
	2023	**€1,223,126**	**38%**
Mallra dhe shërbime	2019	€316,339	13%
	2020	€316,339	14%
	2021	€400,000	19%
	2022	€476,923	17%
	2023	**€476,923**	**15%**
Shpenzime komunale	2019	€50,000	2%
	2020	€50,000	2%
	2021	€50,000	2%
	2022	€50,000	2%
	2023	**€50,000**	**2%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Gjakovës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€100,000	4%
	2020	€100,000	4%
	2021	€100,000	5%
	2022	€100,000	4%
	2023	**€100,000**	**3%**
Shpenzime kapitale	2019	€750,000	31%
	2020	€650,000	28%
	2021	€400,000	19%
	2022	€900,000	32%
	2023	**€1,350,000**	**42%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€2,401,167	**100%**
	2020	€2,301,167	
	2021	€2,131,477	
	2022	€2,770,630	
	2023	**€3,200,049**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Gjakovës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Gjakovës kanë pasur rënie të ndjeshme prej 159 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon zbritje për afro 9% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 353 Euro në muaj, një zbritje prej 35% krahasuar me vitin 2022.

Në vitin 2023 shtesat përbënin 21% të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Gjakovës.

Në Universitetin e Gjakovës ngritjen më të madhe mesatare të të hyrave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 1724 Euro në vitin 2021, në 2040 Euro në 2023. Ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 552 Euro në vitin 2021, në 790 Euro në 2023. Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjakovës



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjakovës



Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Gjakovës

Duke u bazuar në raportin vjetor financiar për vitin 2023 të Universitetit të Gjakovës, ky universitet ka shpenzuar 1,800 Euro për bursa të studentëve, pagesat për hulumtuesin e vitit dhe punëtorin e vitit nga administrata. Në vitin 2020 u patën ndarë 7 mijë e 800 Euro pagesa për punën praktike të studentëve. Për krahasim, gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 31 mijë e 526 Euro për bursa të studentëve, ndërkohë që për vitin 2020, ishin planifikuar të shpenzohen 40 mijë Euro.

Në raportin e tij financiar Universiteti i Gjakovës nuk ka paraqitur shpenzime të ndara për shkencë, por vetëm si të grumbulluara me kategori të tjera të paraqitura në paragrafin më sipër. Gjatë vitit 2020 janë shpenzuar 29 mijë e 70 Euro specifikisht për mbështetje në publikime dhe kërkim shkencor apo projekte mirëpo gjithsej janë shpenzuar 98 mijë e 670 Euro ndërkohë që për vitin 2021 janë planifikuar 100 mijë Euro.

Për shpenzime kapitale Universiteti i Gjakovës në vitin 2023 ka shpenzuar 113,957 Euro. Meqenëse tenderi i ndërtimit të Kampusit është anuluar me vendim të Këshillit Drejtues, pjesa tjetër e mjeteve për shpenzime kapitale është rikthyer në MAShTI.

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 nuk ka paraqitur asnjë gjetje për Universitetin e Gjilanit.

Universiteti i Ferizajt

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Ferizajt ka 46 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 13 gra dhe 33 burra, si dhe 10 të angazhuar, prej tyre 3 gra dhe 7 burra. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: 46 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 13 gra, 33 burra. 10 të angazhuar, 3 gra, 7 burra.
- 2021/2022: 48 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 13 gra, 35 burra. Asnjë të angazhuar.
- 2020/2021: 60 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 22 gra, 38 burra. Asnjë të angazhuar.
- 2019/2020: 45 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 14 gra, 31 burra. Asnjë të angazhuar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Universitetin e Ferizajt në vitin 2022/2023 ishin 1413 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 451 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Ferizajt		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	735	690	739	719
	Djem	498	541	510	617
	Gjithsej	1233	1231	1249	1336
Master	Vajza	120	153	109	60
	Djem	60	96	92	42
	Gjithsej	180	249	201	102
Total		**1413**	**1480**	**1450**	**1438**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Ferizajt		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	142	78	83	105
	Djem	290	43	37	70
	Gjithsej	432	121	120	175
Master	Vajza	10	5	3	7
	Djem	9	0	5	14
	Gjithsej	19	5	8	21
Total		**451**	**126**	**128**	**196**

Nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh i numrit të studentëve në Universitetin e Ferizajt. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020 në Universitetin e Ferizajt në 2022/2023 ka 2% më pak studentë. Vërehet po ashtu një ngritje e dukshme e të diplomuarve për 130% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Ferizajt në vitin 2023 ishte 2,703,351Euro, i ndarë 34% në paga dhe mëditje, 15% në mallra dhe shërbime, 1% në shpenzime komunale, 4% në subvencione dhe grante, dhe 46% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Ferizajt financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Të gjitha mjetet që i gjeneron vet, Universiteti i Ferizajt i shpenzon në paga dhe mëditje. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Ferizajt në vitin 2023 ka pasur një ngritje të dukshme të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 815 mijë e 983 Euro më shumë në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Ferizajt

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€757,712	35%
	2020	€757,712	44%
	2021	€750,334	54%
	2022	€927,712	50%
	2023	**€913,695**	**34%**
Mallra dhe shërbime	2019	€210,696	10%
	2020	€210,696	12%
	2021	€232,326	16%
	2022	€300,000	16%
	2023	**€400,000**	**15%**
Shpenzime komunale	2019	€21,000	1%
	2020	€21,000	1%
	2021	€21,000	1%
	2022	€21,000	1%
	2023	**€21,000**	**1%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Ferizajt

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€56,500	3%
	2020	€56,500	3%
	2021	€56,500	4%
	2022	€70,000	4%
	2023	**€100,000**	**4%**
Shpenzime kapitale	2019	€1,150,000	51%
	2020	€700,000	40%
	2021	€350,000	25%
	2022	€550,000	29%
	2023	**€1,250,000**	**46%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€2,195,908	**100%**
	2020	€1,745,908	
	2021	€1,410,160	
	2022	€1,868,712	
	2023	**€2,684,695**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Ferizajt

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Ferizajt janë përfshirë rektori, prorektorët dhe dekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Ferizajt




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Ferizajt kanë pasur ngritje të ndjeshme prej 116 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon ngritje për afro 7% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 591 Euro në muaj, një ngritje prej 4% krahasuar me vitin 2022. Në vitin 2023 shtesat përbënin 32% të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Ferizajt.


Në momentin kur është bërë matja për vitin 2023 në faqen zyrtare të Universitetit të Ferizajt nuk janë paraqitur prodekanët e fakulteteve. Si rrjedhojë, ata nuk janë të përfshirë në kalkulime.

Në Universitetin e Ferizajt ngritjen më të madhe mesatare të të hyrave mujore e kanë pasur Dekanët nga 1399 Euro në vitin 2021, në 1820 Euro në 2023. Në Universitetin e Ferizajt ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 378 Euro në vitin 2021, në 551 Euro në 2023. Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Ferizajt



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Ferizajt



Në Universitetin e Ferizajt ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 378 Euro në vitin 2021, në 551 Euro në 2023. Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Ferizajt

Universiteti i Ferizajt nuk ka dërguar raport ku mund të vërehen shpenzimet e bursave për studentë. Raportin financiar që e ka dërguar është një version i shkurtër dhe me shumë gabime. Edhe pas kërkesës eksplicite të ORCA-së, Universiteti i Ferizajt nuk e ka dërguar raportin e plotë.

Universiteti i Ferizajt nuk ka dërguar raport ku mund të vërehen shpenzimet për shkencë.

Universiteti i Ferizajt nuk ka dërguar raport ku mund të vërehen artikujt e shpenzimeve kapitale.

Raporti i auditorit për Universitetin i Ferizajt

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 kishte gjetur se në Planifikimin Financiar Vjetor të e vitit 2023, detyrimet kontigjente të Universitetit të Ferizajt nuk ishin prezantuar.

Universiteti i Prishtinës

Sipas Statistikave të Arsimit në Kosovë 2022/2023, Universiteti i Prishtinës nuk ka paraqitur asnjë staf akademik. Andaj, të dhënat e paraqitura për këtë vit akademik janë marrë nga hulumtimet e ORCA-së. Sipas këtyre, Universiteti i Prishtinës ka 911 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 360 gra dhe 552 burra. ORCA nuk posedon të dhëna për stafin e angazhuar. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

- 2022/2023: 911 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 360 gra, 552 burra. Nuk ka të dhëna për të angazhuar.
- 2021/2022: 919 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 360 gra, 559 burra. 404 të angazhuar, 180 gra, 224 burra.
- 2020/2021: 905 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 344 gra, 561 burra. 380 të angazhuar, 163 gra, 217 burra.
- 2019/2020: 891 anëtarë të stafit akademik të rregullt, 337 gra, 554 burra. 473 të angazhuar, 198 gra, 275 burra.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Universitetin e Prishtinës në vitin 2022/2023 ishin 27969 studentë, ndërkaq në 2022 patën diplomuar 4623 studentë. Krahasimi me vitet e kaluara duket kështu:

Numri i studentëve

Universiteti i Prishtinës		2022/2023	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Bachelor	Vajza	14593	15774	16860	17898
	Djem	7404	8777	10264	11633
	Gjithsej	21997	24551	27124	29531
Master	Vajza	3992	3835	3,766	3,687
	Djem	1813	2064	2,070	2,377
	Gjithsej	5805	5899	5836	6064
PhD	Vajza	90	183	21	53
	Djem	77	145	18	25
	Gjithsej	167	328	39	78
Total		**27969**	**30778**	**32999**	**35673**

Numri i të diplomuarve

Universiteti i Prishtinës		2021/2022	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Bachelor	Vajza	2413	2567	2585	2979
	Djem	1130	1271	1,285	1798
	Gjithsej	3,543	3838	3870	4777
Master	Vajza	683	821	721	975
	Djem	374	453	517	829
	Gjithsej	1057	1274	1238	1804
PhD	Vajza	18	15		
	Djem	14	15		
	Gjithsej	32	30	0	0
Total		**4,632**	**5,142**	**5,108**	**6,581**

Vërehet një rënie e dukshme e numrit të studentëve. Në krahasim me vitin akademik 2019/2020 në Universitetin e Prishtinës në 2022/2023 kemi 22% më pak studentë. Po ashtu vërehet një rënie e lehtë e të diplomuarve me 30% për të njëjtën periudhë.

Analiza e Shpenzimeve

Buxheti i Universitetit të Prishtinës në vitin 2023 ishte 32,666,582 Euro, i ndarë 66% në paga dhe mëditje, 10% në mallra dhe shërbime, 4% në shpenzime komunale, 3% në subvencione dhe grante dhe 17% në shpenzime kapitale.

96% i buxhetit të Universitetit të Prishtinës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 4% e gjeneron vet. Universiteti i Prishtinës është i vetmi universitet publik që nuk i shpenzon të gjitha mjetet e gjeneruara vet në paga dhe mëditje, por edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Prishtinës në vitin 2023 ka pasur një ngritje të ndjeshme të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 490 mijë e 238 Euro më shumë në krahasim me vitin paraprak.

Grantet Qeveritare për Universitetin e Prishtinës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	€18,604,884	70%
	2020	€18,327,239	59%
	2021	€18,432,170	69%
	2022	€20,596,599	66%
	2023	**€20,702,582**	**66%**
Mallra dhe shërbime	2019	€3,164,086	12%
	2020	€3,183,954	10%
	2021	€3,063,822	11%
	2022	€2,765,745	9%
	2023	**€2,950,000**	**10%**
Shpenzime komunale	2019	€1,175,000	4%
	2020	€1,175,000	4%
	2021	€1,175,000	4%
	2022	€1,170,000	4%
	2023	**€1,370,000**	**4%**


Grantet Qeveritare për Universitetin e Prishtinës

Linja	Viti	Shuma	% në total të vitit
Subvencione dhe grante	2019	€343,782	1%
	2020	€343,782	1%
	2021	€343,782	1%
	2022	€1,044,000	3%
	2023	**€1,044,000**	**3%**
Shpenzime kapitale	2019	€3,500,000	13%
	2020	€7,900,001	26%
	2021	€4,000,000	15%
	2022	€5,400,000	17%
	2023	**€5,400,000**	**17%**
Totali nga taksapaguesi	2019	€26,787,752	**100%**
	2020	€30,929,976	
	2021	€27,014,774	
	2022	€30,976,344	
	2023	**€31,466,582**	

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Prishtinës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës




Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Prishtinës kanë pasur ngritje të ndjeshme prej 178 Euro krahasuar me 2022. Kjo shënon ngritje për afro 9% nga viti 2022 kur është bërë matja e fundit nga ORCA. Nga këto, shtesa mujore mesatare përbëjnë 748 Euro në muaj, një ngritje prej 33% krahasuar me vitin 2022.


Në vitin 2023 shtesat përbënin 37% të pagave mujore të stafit menaxherial në Universitetin e Prishtinës.

Në Universitetin e Prishtinës ngritjen më të madhe mesatare të të hyrave mujore e kanë pasur anëtarët e Rektoratit nga 1719 Euro në vitin 2021, në 2100 Euro në 2023. Ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Rektoratit, nga 406 Euro në vitin 2021, në 867 Euro në 2023. Në vitin 2022 ORCA nuk ka botuar raport të veçantë për shtesat e stafit menaxherial sipas pozitave, por vetëm si të grumbulluara.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prishtinës



Shtesat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prishtinës



Shpenzimet për shkencë, bursa dhe investime kapitale në Universitetin e Prishtinës

Duke u bazuar në raportin vjetor financiar për vitin 2023 të Universitetit të Prishtinës, ky universitet ka shpenzuar 1,293,028 Euro për bursa të studentëve në tri nivelet e studimit, aktivitete të Zyrës për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara për stafin akademik, projektet dhe financimin e punimeve shkencore. Në vitin 2020, nga kategoria kuotizime dhe botime, UP ka shpenzuar vetëm 2 mijë e 485 Euro, të cilat sipas Raportit Vjetor të asaj kohe, janë përdorë kryesisht për pjesëmarrje në konferenca.

Në raportin e tij financiar Universiteti i Prishtinës nuk ka paraqitur shpenzime të ndara për shkencë, por vetëm si të grumbulluara me kategori të tjera të paraqitura në paragrafin më sipër. Sipas Raportit Vjetor për vitin 2020, UP kishte ndarë bursa në vlerë prej 650 Euro për 1 mijë e 67 studentë, shuma totale e të cilave arrin në 693 mijë e 550 Euro.

Ndërkaq për vitin 2021, UP ka ndarë bursa në vlerë prej 650 Euro për 1 mijë e 290 studentë, shuma totale e të cilave arrin në 774 mijë Euro. Për krahasim me vitin 2019, UP kishte ndarë bursa për 1 mijë e 5827 studentë, me shumën prej 600 Euro për 10 muaj të vitit akademik, shumë kjo e cila kapte vlerën prej 653 mijë e 319 Euro.

Për shpenzime kapitale, Universiteti i Prishtinës në vitin 2023 ka shpenzuar 5,327,640.00€. Shpenzimet kapitale përfshijnë kontratat si në vijim: objekte arsimore renovime 1,339,573 Euro, objekte arsimore për fakultetin e Shkencave Matematike dhe Natyrore 1,400,000 Euro, pajisje të teknologjisë informative për rektorat 240,938 Euro, kompjuterë 183,831 Euro, pajisje speciale mjekësore 458,493 Euro, softuer 19,942 Euro, dhe pajisje të tjera 1,823,721 Euro.

Raporti i auditorit për Universitetin e Prishtinës

Raporti i auditorit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023 ka bërë katër gjetje si në vijim: 1. Mos regjistrimi i pronave në regjistrin e pasurive kapitale; 2. Vonesa në pagesën e faturave; 3. Tejkalim i afateve në procesin e rekrutimit të punonjësve; 4. Mos përdorimi i modulit të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave.

Metodologjia

Objekt i hulumtimit ishin shtatë universitetet publike dhe stafi akademik menaxherial i tyre që përfshijnë rektorët, prorektorët, dekanët, prodekanët dhe anëtarët e këshilleve drejtuese që vijnë nga radhët e profesoriatit. Raporti paraqet gjetje të bazuara në hulumtimin e të dhënave të vitit 2023.

Për krahasime me vitet e kaluara janë marrë për bazë raportet 'Transparenca dhe Llogaridhënia në Universitetet Publike të Kosovës – Menaxhimi I Financave 3' Dhe '3 Vite Hulumtim dhe Monitorim i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë', të publikuara nga ORCA.

Hulumtimi i shpenzimeve të universiteteve publike dhe statistikat e arsimit

Janë hulumtuar shpenzimet e shtatë universiteteve publike duke u bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2023. Nga ky ligj janë marrë shpenzimet e alokuara për vitin 2023 përfshirë grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake të universiteteve.

Janë hulumtuar raportet financiare të dorëzuara pranë këshilleve drejtuese nga menaxhmenti i universiteteve publike. Pesë universitetet publike kanë dorëzuar raporte të plota financiare, ndërkaq dy prej tyre ai i Ferizajt dhe i Gjakovës kanë dorëzuar version të shkurtuar të atij raporti. Nga këto raporte është parë se sa para janë shpenzuar për bursa të studentëve, dhe sa për shkencë që përfshinë financimin për projekte shkencore, shpërblimin për publikime shkencore dhe pagesën e pjesëmarrjes në konferenca shkencore. Jo në të gjitha rastet këto kategori janë treguar si të ndara në raporte financiare. Po ashtu mbi këtë raport janë bazuar edhe gjetjet për shpenzime kapitale të universiteteve publike.

Zyra Kombëtare e Auditmit i auditon të gjitha universitetet publike përmes MAShTI-të, përveç Universitetit të Prishtinës që është organizatë e veçantë buxhetore i cili ka një raport të veçantë të auditimit. Për qëllimet e këtij hulumtimi janë shfrytëzuar raportet e auditimit të MAShTI-të dhe UP-së.

Të dhënat për numër të stafit dhe të studentëve janë marrë nga raporti Statistikat e Arsimit 2022-2023. Përjashtim bën vetëm Universiteti i Prishtinës për të cilin nuk ka pasur statistika sa i përket numrit të stafit akademik të rregullt dhe të angazhuar.

Numri i programeve të studimit për secilin universitet publik është marrë nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Hulumtimi i pagave të stafit akademik menaxherial

Gjatë muajit qershor 2024 është bërë mbledhja e të dhënave nga deklarimet e pasurisë që anëtarët e stafit akademik menaxherial i kanë bërë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në mars të vitit 2024, për të hyrat e tyre në vitin 2023.

Meqenëse hulumtimi është fokusuar vetëm në pagat që i kanë marrë anëtarët e stafit menaxherial për ligjërata dhe ushtrime, në analiza nuk janë llogaritur pagesat jashtë kategorisë Paga Neto përmes Listës së Pagave. Në hulumtim nuk përfshihen kompensimet që janë marrë për punë të tjera si komisione, projekte, as nuk përfshihen mëditjet për udhëtime dhe kompensimet e tjera për punë jashtë ligjëratave dhe ushtrimeve.

Analiza e të hyrave të stafit akademik ka për qëllim të identifikojë se në çfarë vlere përmbi pagën bazë paguhet stafi akademik nga universitetet publike për ligjërata dhe ushtrime.

Për arsye të këtij hulumtimi dhe për të vendosur një prag mbi të cilën mund të maten hulumtimet e tjera, paga bazë është llogaritur sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik 08/L-196.

Ligji për pagat

Në janar të vitit 2023 ka hyrë në fuqi Ligji për Pagat në Sektorin Publik 08/L-196, i cili rregullon nivelin e kompensimit të pozitave që paguhen nga buxheti i Kosovës. Ligji ka përcaktuar koeficientët, mbi të cilët kalkulohet paga varësisht nga vlera e koeficientit, që në vitin 2023 ka qenë 105 Euro. Në figurën e mëposhtme mund të shihen kompensimet sipas pozitave akademike dhe drejtuese në arsim të lartë në Kosovë.

NR.	EMËRTIMI I POZITËS	GRUPI	KLASA	KOEFICINETI
1	Rektor		E1	14.2
2	Pro - Rektor		E2	13
3	Dekan		E3	12.8
4	Pro - Dekan		E4	12.6
5	Profesor i rregullt		E5	12.4
6	Profesor i asocuar		E6	11.4
7	Profesor asistent		E7	10.4
8	Ligjërues		E8	8.6
9	Lektor/korepetitor		E9	7.5
10	Asistent /Hulumtues i Pavarur		E10	7.2
11	Asistent i ri / Hulumtues		E11	6.6
12	Laboranti në Universitet		E12	6.4

Tabela e numrit të koeficientit që përcakton nivelin e kompenzimit të stafit akademik publik në Kosovë

Sipas ligjit, profesorët që mbajnë ligjërata dhe angazhohen në një pozitë drejtuese në fakultet ose universitet mund të marrin si shtesë funksionale kompensim deri në 20% mbi pagën bazë.

> *Profesoret/ët universitare/ë, në rastet kur kryejnë edhe funksionet si rektor/e, prorektor/e, dekan/e, prodekan/e dhe shef/e e/i departamentit, përfitojnë shtesë funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë të profesores/it universitar/e. – Ligji për Paga në Sektorin Publik.*

Stafi akademik i cili ka pasur kontratë valide para se të hyj ligji në fuqi ka përfituar kompensim sipas dispozitës kalimtare të ligjit, që do të thotë nuk do të ketë zbritje të pagës. Ndërkaq ata që kanë nënshkruar kontratë të re pas hyrjes në fuqi të ligjit, kanë pasur kompensim sipas koeficientëve të caktuar në ligj.

Koeficienti në vitin 2023 e ka pasur vlerën 105 Euro.

Kufizimet metodologjike

Ligji për paga ka hyrë në fuqi në kohën kur disa nga kontratat e stafit menaxherial akademik kanë qenëaktive me bazë rregullative të vjetër. Meqenëse është e pamundur të verifikohet secila kontratë se kur është nënshkruar, atëherë ky hulumtim për bazë e ka marrë vetëm ligjin e ri të pagave dhe jo rregullativat e vjetra, tek të cilat kompensimi mund të ketë qenë ndryshe.

Në varësi prej viteve të përvojës së punës stafi akademik ka të drejtë në shtesa, dhe meqenëse për ta identifikuar këtë shtesë do të duhet të shikohet secila kontratë veçmas, atëherë ky hulumtim është bazuar vetëm mbi koeficientet bazë sipas ligjit të pagave.

Universitetet publike jo në të gjitha rastet i kanë paraqitur të ndara shpenzimet për bursa dhe shkencë. Në këto raste ato janë paraqitur si të grumbulluara.
Në Statistikat e Arsimit 2022/2023, për Universitetin e Prishtinës nuk ka pasur të dhëna për stafin akademik, andaj në këtë rast janë shfrytëzuar statistikat që i ka pasur ORCA.

Bibliografia

-Enver Mekolli et al. (2023) Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/2023. Agjencia e Statistikave të Kosovës
-Enver Mekolli et al. (2022) Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021/2022. Agjencia e Statistikave të Kosovës
-Enver Mekolli et al. (2021) Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021. Agjencia e Statistikave të Kosovës
-Enver Mekolli et al. (2020) Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020. Agjencia e Statistikave të Kosovës
-Vlora Spanca nënshkruar. (2024) Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Universitetit të Prishtinës për Vitin 2020. Zyra Kombëtare e Auditimit.
-Vlora Spanca nënshkruar. (2024) Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit për Vitin 2020. Zyra Kombëtare e Auditimit.
-Liridona Ademaj, Skord Retkoceri. (2021) Transparenca dhe Llogaridhënia në Universitetet Publike të Kosovës - Menaxhimi I Financave. Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

-Adea Kondirolli. (2022) 3 Vite Hulumtim dhe Monitorim i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë. Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
-(2024) Raporti Vjetor i Buxhetit. Universiteti i Gjilanit.
-Armand Krasniqi dorëzuar. (2024) Raporti i Buxhetit për vitin 2023. Universiteti i Pejës.
-Azem Ramadani dorëzuar. (2024) Raporti i Punës dhe i Shpenzimit të Buxhetit për Vitin 2023. Universiteti i Prizrenit.
-Burim Hasani nënshkruar. (2024) Raporti i të Hyrave dhe Shpenzimeve për Periudhën Janar/Dhjetor – 2023. Universiteti i Mitrovicës.
-Armend Hysa. (2024) Raporti Vjetor Financiar – Versioni i Shkurtuar. Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj.
-Linda Dula Halilabazi. (2024) Raporti Vjetor Financiar – Versioni i Shkurtuar. Universiteti i Gjakovës.
-Pranvera Breznica-Selmani. (2024) Draftraporti i shpenzimit të buxhetit për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023. Universiteti i Prishtinës

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim